



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:051701

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491765

Ac.nr.8039/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajzazi - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Bujar Muzaqi -anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh. Sh., me numër personal xxxx, me vendbanim në rr. xxxx, në P, të cilën me autorizim e përfaqëson av. F.S. nga Gjilani, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson Bejtulla Likaj nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 2,293.20 euro (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre euro e njëzet cent), duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.424/2021, të datës 20.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.03.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHEN SI E PA THEMELTË, ankesa e të paditurës, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, në Prizren, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.424/2021, i datës 20.09.2022, VËRTETOHET.

II. Pika e III-të e dispozitivit të Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.424/2021, i datës 20.09.2022, ngelet e pa shqyrtuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.424/2021 të datës 20.09.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Sh. Sh., nga P.. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, që paditëses Sh. Sh., nga P., në emër të shpërblimit jubilar për 33 vite përvojë pune, ti paguaj shumën e përgjithshme prej një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e tridhjetë e

një cent (1,979.31 euro), me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (datë 19.03.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka refuzuar të pa bazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë, përtej shumës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e përgjithshme të kërkuar, në lartësi prej dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre euro e njëzet cent (2,293.20 euro) dhe në pikën e IV të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro (269.00 euro), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar duke e hedh poshtë padinë e paditëses apo që ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja ka ushtruar përgjegjje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të palës së paditur me propozimin që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, Sh. Sh. nga P., përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, F.S., avokat nga Gjilani, me datën 19.03.2021, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 2,693.20 euro. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë 30 euro në emër të taksës gjyqësore, 104 euro për përpilimin e padisë dhe 135 euro për përfaqësim në seance.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Gjithashtu ka theksuar se paditësja Sh. Sh. është në marrëdhënie pune në Qendrën e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi, nga data 01.10.2002, dhe me datën 01.10.2012, ka arritur 10 vjet përvojë pune andaj kërkesa e paditëses është pa bazuar. Tutje ka shtuar se pagesën për shpërblimin jubilar e kundërshton pasi bazuar në Ligjin e punës, nr.03/L-212, neni 87, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) viteve. Ka theksuar se paditësja marrëdhënien e punës tek e paditura e ka filluar me datën 01.10.2002, ndërsa 10 vite të përvojës së punës i ka mbushur me 01.10.2012, andaj edhe ky vit ka qenë për të jubilar, dmth viti kur Marrëveshjen e

Përgjithshme Kolektive nuk ka qenë në fuqi. Meqenëse paditësja nuk e ka kërkuar shpërblimin jubilar në vitin 2012, atëherë ka të bëjë me parashkrimin e kërkesës. Edhe gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se gjatë administrimit të provave, vërtetimit të lëshuar nga Qendra e Shëndetit Mendor, nga marrëveshja e përgjithshme kolektive, është paraparë qartë afati për pagesë 3 vjeçar. Ka shtuar se paga bazë për paditësen është 656.77 euro, e jo siç pretendohet 764.40 euro, sepse ky vlerësim është bërë në mënyrë paushallë, ku është përfshirë edhe kujdestaria. Në fund ka kërkuar që padia dhe kërkesëpadija e paditëses të refuzohet si e pabazuar, pasi nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e saj. E ka kundërshtuar edhe kamatën ligjore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin kryesor, dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.424/2021, të datës 20.09.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura. Nga vërtetimi numër 03 i datës 04.03.2021, lëshuar nga Qendrën e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar pranë Qendrës për Shëndetin Mendor dhe Shtëpisë për Integrim në Bashkësi nga datës 01.10.2002, dhe e njëjta ka përvojë pune prej 18 vite, 5 muaj e 3 ditë, pranë këtij institucioni. Nga lista e pagave me nr.EM00037194, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka rrogën bazë prej 659.00 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) euro, si dhe përvoja e punës në institucionet shëndetësore për këtu paditësen, është 33 vite. Në fund, gjykata e aprovoi pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke e mbështetur vendimin e saj në nenit 17 paragrafi 3 të Kontratës Kolektive Sektoriale. Në raport me kamatën ligjore gjykata vendosi konform nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve procedurale vendimin e mori bazuar në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së. Gjykata, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pas vlerësimit të të gjitha provave të administruara dhe atë vërtetimi me nr. të protokollit 64/08, i dt.30.05.2022, lëshuar nga Qendrën e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi në Prizren, ku i rezultojë gjykatës se paditësja Sh. Sh., nga P., realizon pagën bazë mujore në shumën prej gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e shtatë cent (659.77 €), e jo vlera e kërkuar si në kërkesëpadi. Kjo pasi që si pagë mujore konsiderohet paga bazë dhe jo pagesa të cilën e merr punëtori së bashku me shtesat tjera ku përfshihen pagesat për shujtat dhe kujdestarinë e të cilat i ka llogaritur paditësja në kërkesën e saj.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit

194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse për një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur se kërkesëpadia është e parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës 03/L-212, mirëpo gjeti se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo për kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, andaj paditësja mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, dhe nuk qëndron fakti se paditësja nuk mund ta kërkojë këtë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura ashtu siç pretendon e paditura, përkundrazi, e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditëses në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lart.

Po ashtu kërkespadia e paditëses nuk është e parashkruar as në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës 03/L-212, për faktin se nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja ka mbi 30 vite përvojë pune në shëndetësi, konkretisht nga lista e pagës në emër të paditëses konstatohet se e njëjta ka 33 vite përvojë pune dhe se sipas përlllogaritjes matematikore, paditësja rapordin juridiko-marrëdhënien e punës e ka krijuar në vitin 1988 dhe që 30 vitë të përvojës së punës- vitin jubilar

e ka arrit në vitin 2018, ndërsa padinë e ka ushtruar me datë 19.03.2021, andaj kërkespadia e paditëses është e afatshme sipas nenit 87 të Ligjit të Punës 03/L-212 ku parashihet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, si rrjedhojë nuk kemi parashkrim të kërkespadisë.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëseve që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë t’ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është vërtetimi lidhur me ditët e pranisë në punë për paditëset, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë, pika e III-të e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është atakuar me ankesë, gjykata e shkallës së dytë, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor nga neni 194 i LPK-së (kufinj të ekzaminimit të ankesës), nuk e shqyrtoi fare.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8039/2022, datë 22.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,  
Ardian Ajvazi